

VENDIM
Nr. 487, datë 10.6.2015

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 513, DATË 13.6.2013, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E TË
DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË
HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 30, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në aneksin nr. 3, “Lista e shteteve, shtetasit e të cilëve hyjnë pa viza në Republikën e Shqipërisë dhe çfarë dokumenti duhet të paraqesin”, bashkëlidhur vendimit, të shtohen fjalët “...Arabia Saudite, Katari, Omani, Bahrejni, Rusia, Gjeorgjia, Bjellorusia, me dokumentin pasaportë, për periudhën 1 qershor - 1 nëntor 2015...”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama